



KOMUNA E PRISHTINËS
RAPORT MUJOR

Drejtoria	Drejtoria e Arsimit
Periudha Raportuese	Shtator, 2020
Emri dhe mbiemri i raportuesit	Fatos Osmani

1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Pavarësisht sfidave dhe peripecive të mëdha që ka paraqitur përhapje e pandemisë COVID-19, Drejtoria e Arsimit gjatë muajit shtator, me përkushtim të madha ka arrite të realizojë punë dhe detyra të shumta të parapara sipas planit të veprimit dhe punë dhe detyra të tjera të paraqitura.

Muaji shtator ka qenë muaj me punë dhe dinamizëm të lartë, me theks të veçantë përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, në këtë kohë pandemie.

AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara sipas planprogramit të Komunës për drejtorinë tuaj:

- Mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit edukativo-arsimor;
- Vizita të përgjithshme-këshilluese në institucionet arsimore;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;

- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performances;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta në mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;
- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave, me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimdhënësve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësimdhënie dhe të nxënë cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi, që janë të interesuar të kontribuojnë në shkolla;
- Rritja e llojeve të shërbimeve (dhe gjenerimi i të hyrave për rritje të numrit të fëmijëve të përfshirë në IP) të edukimit parashkollor;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;

- Organizimi i mësimi joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimi Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimdhënësit që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin, me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takimet të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV-në dhe nxënësit me talente;
- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektive;
- Indeksi i sigurisë;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Furnizimi me dru i institucioneve edukativo-arsimore;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me materiale të domosdoshme për mbrojtjen nga virusi COVID-19;
- Furnizimi i disa shkollave me material higjienik;
- Furnizimi i disa shkollave me material didaktik;
- Përfundimi i procedurave për fillimin e furnizimit të shkollave me pelet;
- Planifikimi i furnizimit të shkollave me naftë etj.;
- Përcjella dhe realizimi i projekteve nga donatorët;
- Evidentimi i të hyrave vetanake;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimit të lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve;
- Barazimi i pagesave me freebalance.

2. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e Drejtorisë.

- Mbështetja dhe mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar në komunën tonë, është duke u realizuar në vazhdimësi nga zyrtarët e Arsimit, të cilët sipas planit dinamik janë duke operuar në terren dhe duke i përcjellë nga afër ecurinë e zhvillimeve në arsim, dhe njëkohësisht duke i mbështetur shkollat me këshilla profesionale në këtë kohë pandemie që po kalon vendi.

Sipas dinamikës së planifikuar, përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, gjatë muajit shtator kanë realizuar planin operues, si: vizita informuese, kontrolluese, speciale dhe të përgjithshme në institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar. Pra, në kuadër të mbikëqyrjes dhe mbështetjes profesionale në të gjitha dimensionet që janë paraqitur nevojat. Kështu që, sipas planifikimit dhe dinamikës së paraparë, gjatë muajit shtator të vitit 2020 është realizuar planin e punës. Pra, në këtë periudhë raportuese janë realizuar **27 vizita informuese, në të gjitha institucionet edukativo-arsimore, për të parë nga afër përgatitjet për fillim vitin e ri shkollor 2020-2021, në:**

- SHFMU “Iliria”;
- SHFMU “Hilmi Rakovica”;
- SHFMU “Meto Bajraktari”;
- SHFMU “Nazim Gafurri”;
- SHFMU “Dituria”;
- SHFMU “Pavarësia”;
- SHFMU “Afrim Gashi”;
- SHFMU “Shkëndija”;
- SHFMU “Gjergj Fishta”;
- SHFMU “Naim Frashëri”;
- SHFMU “Pjetër Bogdani”;
- SHFMU “Asim Vokshi”;
- SHFMU “Zenel Hajdini”;
- SHFMU “Mitrush Kuteli”;
- SHFMU “7 Marsi”;
- SHFMU “Dardania”;
- SHFMU “Shkolla e Gjelbër”;
- SHFMU “Nexhmi Mustafa”;
- SHFMU “Andon Z. Çajupi”;
- SHFMU “Ganimete Tërbeshi”;
- SHFMU “Tefik Çanga”;
- SHFMU “Rilindja”;
- SHFMU “Dëshmorët e 1921”;
- SHFMU “Azemi e Salihu”;
- SHML “Xhevdet Doda”;
- SHML “Dr. Ali Sokoli” dhe

- SHML “Eqrem Çabej”.
- **Vizitë kontrolluese lidhur me ecurinë dhe mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor, respektimit të masave kundër COVID-19, mbajtjes së pastërtisë në shkollë etj, në:**
 - SHFMU “Meto Bajraktari”;
 - SHFMU “Hilmi Rakovica”;
 - SHFMU “Zenel Hajdini”;
 - SHFMU “Elena Gjika”;
 - SHFMU “Gjergj Fishta”;
 - SHML “Ahmet Gashi”;
 - SHFMU “Pavarësia”;
 - SHFMU “Iliria”;
 - SHFMU “Ismail Qemali”;
 - SHFMU “Dardania”;
 - SHFMU “Xhemail Mustafa”;
 - SHFMU “Hasan Prishtina”.

Dhe një vizitë speciale, në shkollën fillore “Naim Frashëri”.

Mësimi në distancë

Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës, në koordinim dhe bashkëveprim me Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe mekanizma të tjerë mbështetës, kanë vazhduar me xhirimin e njërive mësimore për mësimin në distancë, për nivelin e arsimit fillor (I-V) dhe nivelin e arsimit të mesëm të ulët (VI-IX);

- **Takim me KP në nivel komune dhe me kryetarët e KDSH -ve**

Drejtoria e Arsimit, më 9 shtator 2020, ka realizuar takim me kryetar të këshillave drejtuese të shkollave të Komunës së Prishtinës dhe KP të të Prishtinës, për t’u dakorduar bashkë për fillimin e vitit të ri shkollor, detyrat dhe përgjegjësitë e secilës palë. Pra, secili nga ta shprehi gatishmërinë e lartë për mbështetje në realizimin e punëve dhe detyrave të përcaktuara, me kompetencë dhe përgjegjësi në institucionet përkatëse, në mënyrë që procesi edukativ në këtë kohë pandemie të rrjedhë mbarë.



Ngritja profesionale e mësimeve për zbatim të KK-së

Në vazhden e mbështetjes dhe zhvillimit profesional të mësimeve dhe stafit tjetër arsimor, Drejtoria e Arsimit e Komunës së Prishtinës në koordinim me Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës, nga data 03-08 shtator 2020 kanë vazhduar me organizimin e fazës së dytë të trajnimit, për mësimeve e ciklit klasor, duke i përgatitur dhe zhvilluar profesionalisht gjithsej 18 mësimeve. Drejtoria e Arsimit, në mënyrë që ky proces i filluar të gjejë zbatueshmëri të duhur në institucionet edukativo-arsimore të nivelit të arsimit parauniversitar, ka ndërmarrë veprime konkrete, duke iu përgjigjur profesionalisht këtyre zhvillimeve.

Gjithsej në këtë fazë janë trajnuar 18 mësimeve, të ndarë 2 grupe, të një fushe kurrikulare:

Nr.	Fusha e kurrikulës	Numri i grupeve	Numri i vijuesve
2	Niveli fillor	2	18

Po ashtu, edhe kjo fazë e trajnimit është përcjellë dhe mbikëqyrur në mënyrë të vazhdueshme nga përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit, për t'u siguruar se i gjithë procesi i trajnimit të mësimeve është duke u realizuar sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara;

- Drejtoria e Arsimit, më 8.9.2020, ka realizuar takim me drejtuesit e të gjitha institucioneve edukativo-arsimore, lidhur me përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021.
Në këtë takim u trajtuan shumë çështje në të gjitha dimensionit, se a janë realizuar përgatitjet e duhura për fillimin e vitit shkollor, mbase gjendemi në kohë pandemie, ku parësore, përveç cilësisë në arsimit, gjatë kësaj periudhe është sigurimi i shëndeti për të gjithë të përfshirë në procesin edukativo-arsimor;
- Në koordinim dhe bashkëveprim me Drejtorinë e Arsimit, Ministria e Arsimit dhe Shkencë dhe Ministrinë e Arsimit e Shqipërisë, në shkollën fillore "Faik Konica", kanë shpalosur platformën digjitale për nxënësit e nivelit të arsimit parauniversitar;
- Në fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021, përfaqësuesit e Drejtorisë së Arsimit kanë realizuar vizita të përbashkëta me ministrin e Arsimit, z.Likaj, dhe me ministrin e Shëndetësisë, z. Zemaj, në institucionet edukativo-arsimore, për të parë nga afër përgatitjet e bëra për këtë fillimvit shkollor dhe a janë marrë të gjitha masat e duhura për t'u mbrojtur nga COVID-19;

- Në funksion të krijimit të kushteve sipas standardeve dhe kërkesave të parapara për edukim dhe arsimim cilësor, Drejtoria e Arsimit gjatë muajit shtator ka intervenuar në përmirësimin e infrastrukturës së brendshme në institucionin parashkollor “Gëzimi Ynë” dhe në paralelen e ndarë të shkollës “Nexhmi Mustafa”, në Prugovc, duke zgjeruar hapësirën e institucionit dhe përmirësimin e hapësirës së brendshme, konkretisht rregullimin e tualeteve dhe gëlqerosjen e klasave.



Po ashtu, gjatë muajit shtator është intervenuar në përmirësimin e infrastrukturës edhe në shkollat tjera ku është paraqit kërkesë dhe nevojë;

- Në funksion të implementimit dhe zbatimit të kurrikulës së re sipas kërkesave dhe standardeve të përcaktuara, Drejtoria e Arsimit në koordinim me ekipin profesional në nivel komune, janë duke iu përgjigjur në mënyrë profesionale zhvillimeve reformuese, duke organizuar edhe punëtori, me qëllim zgjidhjen dhe tejkalimin e sfidave të paraqitura;
- Në bazë të mbështetje profesionale dhe të vazhdueshme që është duke ju ofruar mësimdhënësve dhe drejtuesve të shkollave nga ekipi profesional, implementimi i KK-së në shkolla tona është duke u monitorua dhe zbatuar relativisht mirë, pavarësisht sfidave;
- Aktivitetet profesionale (seksionet), në funksion të zhvillimeve të proceseve progresive në sistemin e arsimit dhe ngritjes së cilësisë në arsim, gjatë kësaj periudhe kanë realizuar punët dhe detyrat e përcaktuara dhe në fund muajit kanë përgatitur raporte mbi ecuritë dhe zhvillimet e përgjithshëm në shkollë. Po ashtu, aktivitetet profesionale në vazhdimësi janë duke u mbikëqyrë dhe mentorua nga drejtuesit e shkollave përkatëse për punën e tyre, ndërsa Drejtoria e Arsimit në vazhdimësi i mbështetë me këshilla profesionale aktivitetet profesionale dhe i ka informuar për rëndësinë e madhe që kanë në zhvillimin e arsimit, dhe u ka përgatitur formën raportuese për punët dhe detyrat e realizuara për çdo muaj;

- **Marrëveshje bashkëpunimi**

Drejtoria e Arsimit në funksion të mbështetjes dhe reformave arsimore, gjatë muajit shtator, ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me AAAP-në, që nxënësit e shkollës së mesme profesionale “Shtjefën Gjeçovi”, të drejtimit Konfeksion, të përgatitin dhe të realizojnë qepjen e maskave për nxënësit e shkollave të Komunës së Prishtinës, ku lënda e parë do të sigurohet nga Komuna.



Një veprim i tillë sigurisht

që do të reflektojë pozitivisht në shumë dimensione për shkollën dhe nxënësit e saj, ku puna praktike do t'i ndihmojë në zhvillimin e tyre dhe njëkohësisht në arritjen e kompetencave, shkathtësitë e tyre profesionale të parapara edhe sipas planprogramit;

- Përgatitja e raportit për suksesin dhe rezultatet e nxënësve të arritura në tri nivelet e arsimit parauniversitar, në shkollat publike dhe private për vitin shkollor 2019-2020;
- Grumbullimi dhe përpunimi i të dhënave, mbi rezultatet dhe suksesin e arritur në secilën lëndë gjatë vitit shkollor 2019-2020, në të tri nivelet e arsimit parauniversitar;
- Janë procesuar të dhënat e të gjitha institucioneve arsimore të nivelit fillor, të mesëm të ulët dhe atij të mesëm të lartë në sistemin EMIS/SMIA, për vitin shkollor 2019-2020;
- Për vlerësimin e nxënësve-fëmijëve me nevoja të veçanta, ekipi në nivel komune ka operuar sipas planifikimeve të parapara për vlerësimin dhe adresimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në institucionet përkatëse;
- Drejtoria e Arsimit, me kohë të duhur ka përcjellë Udhëzimin administrativ 08/2016, për vlerësimin e nxënësve sipas kornizës së kurrikulës së arsimit parauniversitar të Republikës së Kosovës dhe njëkohësisht modelin sipas standardeve të kërkuara për vlerësim. Po ashtu, janë përcjellë edhe informata të tjera të domosdoshme në të gjitha institucionet e nivelit të arsimit parauniversitar dhe janë dhënë këshilla të nevojshme për këtë proces, por duhet theksuar se vlerësimi akoma mbetet sfidë dhe ka nevojë për mbështetje permanente;
- Në rast se ka tendencë për çfarëdo dhune apo shkelje të të drejtave të fëmijëve-nxënësve në institucionet arsimore, drejtoria merr masa të menjëhershme komfor

legjislacionit në fuqi të Republikës së Kosovës dhe Rregullores komunale për arsim;

- Takime të rregullta me zyrtarë për arsim në DKA, për të trajtuar çështje me interes e që ndërlidhen me ato të sigurisë në shkolla;
- Takime me prindër të shkollave të ndryshme;
- Vizita në shkolla sipas kërkesave të shkollave, prindërve apo nxënësve;
- Takim me palët e interesit dhe zyrtarë komunalë nga drejtoritë tjera përkatëse;
- Shqyrtimi dhe kthimi i përgjigjeve të të gjitha shkresave zyrtare të paraqitura gjatë muajit shtator;
- Pjesëmarrja në procedurat e hapjes dhe vlerësimeve të tenderëve për nevojat e institucioneve arsimore. Në procesin e hapjes dhe vlerësim të tenderëve marrin pjesë gjithnjë nga tre përfaqësues të Drejtorisë së Arsimit;
- Janë furnizuar në vazhdimësi të gjitha institucionet me materiale didaktike, higjienike dhe mallra dhe shërbime tjera;
- Furnizimi i institucioneve edukativo-arsimore me materiale të domosdoshme për mbrojtjen nga COVID-19;
- Furnizimi me dru i institucioneve edukativo-arsimore;
- Përfundimi i procedurave për fillimin e furnizimit të shkollave me pelet;
- Furnizimi me libra i bibliotekave shkollore;
- Planifikimi i furnizimit me naftë i shkollave;
- Nënaloqimet e pagave për institucionet shkollore;
- Nënaloqimet e mjeteve për mallra dhe shërbime në nënprograme;
- Shpenzimet komunale për institucionet shkollore;
- Pranimi i lëndëve për aprovim;
- Zotimi i lëndëve.

3. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtoria juaj për muajin raportues:

- Vizita të vazhdueshme, të përgjithshme, kontrolluese dhe speciale në institucionet edukativo-arsimore;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA – shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performances;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e hvilluara;
- Furnizimi me inventar i shkollave;
- Furnizimi me pelet;
- Furnizimi me naftë etj.

3.1.1. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

3.1.2. Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese shtator-2020

Buxheti i shpenzuar dhe alokimet për muajin shtator-2020				
Kadegoria eko.	Alokim	Shpenzim	Zotim -Oblig.	Mbetje -S=
Paga	1,489,905.53	1,489,905.53	-	-
Komunali	193,633.68	7,052.56	4,842.32	181,738.80
10-MSH	537,012.16	215,574.24	145,000.00	176,437.92
21-MSH	275,736.2	-	-	275,736.16
Subvencione	107,730.00			107,730.00
Donacione	28,056.48	22,053.86	-	6,002.62
Huaja-grant i BB	137,681.50	-	6,861.00	130,820.50
FB-21-Kapitale	1,002,550.37	54,500.00	110,332.50	837,717.87
FB-22-Kapitale	2,383,999.84	35,872.95	365,027.05	1,983,099.84
Totali:	6,156,305.72	1,824,959.14	632,062.87	3,699,283.71

3.1.3. Takimet me palë:

- Drejtoria e Arsimit, gjatë muajit shtator ka realizuar mbi 84 takime me palë;
- Takimet me palë në Drejtorinë e Arsimit janë të planifikuara katër gjatë 4 ditëve të javës.

4. Takimet me institucione të tjera

Për periudhën e muajit shtator të vitit 2020, janë realizuar takime me:

- ministrin e Arsimit dhe Shkencës;
- zyrtarët e MASHTI;
- përfaqësuesit e SBASHK;
- përfaqësuesit e GIZ-së;
- përfaqësuesit e Klubit të Astronomëve Amatorë të Kosovës në Observatorin e Prishtinës;

- përfaqësuesit e Zyrës japoneze;
- përfaqësuesit e UNICEF;
- përfaqësuesit e LUX-DEV;
- përfaqësuesit e KRU “Prishtina”;
- përfaqësuesit e KEDS;
- përfaqësuesit e PTT;

4.1.1. Diskutime publike/takimet me qytetarë

5. Kërkesat për qasje në dokumente zyrtare

- Gjatë muajit shtator në Drejtorinë e Arsimit nuk është adresuar asnjë kërkesë për qasje në dokumente zyrtare.

5.1.1. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër

- Gjatë muajit shtator janë pranuar gjithsej 122 lëndë, prej tyre të miratuara janë 12, të refuzuara 15, të pezulluara 55 lëndë, dhe në proces janë edhe 38 lëndë për paga jubilarë.

6. Takime të tjera

- Takime me drejtues të institucioneve edukativo-arsimore;
- Takim me Këshilla drejtues të shkollave;
- Takime me mësimdhënës.

7. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda drejtorisë, komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutem shpjegoni në këtë hapësirë.

- Riorganizimi dhe përcaktimi, përgjegjësive, punëve dhe detyrave në Drejtorinë e Arsimit;
- Mungesa e një stafit profesional e mbikëqyrës të veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Mungesa e një mekanizmi për vlerësimin e performancës së stafit edukativo-arsimor;
- Mungesa e zyrtarëve ligjorë në Drejtorinë e Arsimit;
- Numri i vogël i nxënësve në disa shkolla të viseve rurale;
- Kompetenca të përziera dhe jo të qarta;
- Përhapja e pandemisë COVID-19;
- Fillimin e vitit të ri shkollor 2020-2021.
- Mbulimi i orëve mësimore për mësimdhënësit që vuajnë nga sëmundjet e rënda dhe të infektuarit me virus COVID-19.

8. REKOMANDIME

Shënoni rekomandime rreth përmirësimit të mbarëvajtjes së proceseve, nëse keni, dhe nevojave të drejtorisë për të gjitha aspektet, p.sh. trajnime të punëtoreve, furnizim me pajisje shtesë etj.

- Riorganizimi i menjëhershëm i Drejtorisë komunale të Arsimit, në bazë të përgjegjësi, punëve dhe detyrave që ka kjo drejtori;
- Plotësimi i stafit profesional sipas kërkesave dhe nevojave të Drejtorisë së Arsimit;
- Formimi i një organi mbikëqyrës të performancës së veprimtarisë edukativo-arsimore;
- Riorganizimi i rrjetit shkollor të viseve rurale të komunës së Prishtinës;
- Institucionet e nivelit qendror të nxjerrin një vendim të qartë dhe në përputhje me ligjet në fuqi, se si do të realizohet angazhimi i stafit të ri arsimor në raste të infektimit me virusin COVID-19 dhe sëmundjeve të rënda, në mënyrë që mos të kemi mungesa të stafit arsimor në shkolla.

9. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR MUAJIN PASUES

Listoni aktivitetet e planifikuara për drejtorinë tuaj për muajin pasues

- Mbikëqyrja e procesit edukativo-arsimor;
- Vizita sistematike në institucionet edukativo-arsimore;
- Vizita speciale IEAA;
- Përkrahja e shkollave për përmirësimin e performancës në bazë të rezultateve të vlerësimit të jashtëm;
- Mbikëqyrja/ mentorimi i aktiveve profesionale (seksionet);
- Fuqizimi i aktiveve profesionale;
- Sigurimi i buxhetit adekuat për realizimin e objektivave të planit strategjik;
- Stimulimi i menaxhmentit (DKA - shkollë), mësimdhënësve të dalluar sipas performancës;
- Vizita studimore jashtë vendit për zyrtarët, drejtorët dhe mësimdhënësit, për të qenë në hap me ndryshimet dhe risitë arsimore në vendet e zhvilluara;
- Organizimi i punëtorive të përbashkëta mes institucioneve relevante për identifikimin dhe tejkalimin e sfidave dhe problemeve në zbatimin e kurrikulës së re;
- Zbatimi i planit për tejkalimin e masave/ sfidave/ vështirësive/ pengesave;

- Monitorimi i zbatimit të kurrikulës;
- Organizimi i takimeve dhe punëtorive për ndarje të përvojave e praktikave të mira në zbatimin e kurrikulave me përfshirje relevante të shkollave (pilot) dhe palëve të interesit;
- Aftësimi dhe informimi i mësimeve dhe i nxënësve lidhur me vlerësimin e standardizuar;
- Sigurimi dhe menaxhimi i fondeve për përmirësimin e infrastrukturës, në përputhje me kërkesat për zbatim optimal të kurrikulës së re. Kryesisht sigurohen pajisjet dhe mjetet materiale për mësime dhe të nxënësve cilësor në klasat dhe vitet që zbatojnë kurrikulën e re;
- Identifikimi i organizatave, bizneseve dhe komunitetit në përgjithësi që janë të interesuar të kontribuojnë në shkollë;
- Zhvillimi i partneriteteve për rritjen e përfshirjes dhe sigurimin e kontributeve të jashtme;
- Zbatimi i programeve të trajnimit për edukim parashkollor;
- Aftësimi i personelit për përdorimin e metodologjive pedagogjike në zbatim të KKK-së dhe KB-së në edukimin parashkollor (Montessori, Reggio Emilia, Hap pas Hapi, Majeutika);
- Angazhimi i psikologut, pedagogut, edukatorit mbështetës, pediatrit, nutricionisti, e të tjerë në IP, me orar të organizuar sipas UA për numër të fëmijëve në IP;
- Përkrahja për përmirësimin e zbatimit të standardeve të EPSH;
- Operimi i ekipit vlerësues profesional për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore;
- Integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta në institucione edukativo-arsimore;
- Monitorimi dhe integrimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe rekomandimet për adresim më efektiv të problemeve;
- Organizimi i mësimit joformal në tri nivelet e arsimit (në bashkëpunim me MASHT dhe Qendrën Rajonale të Aftësimin Profesional);
- Sanksione të qarta dhe të zbatueshme për mësimeve që ushtrojnë çfarëdo dhune dhe shkelje të të drejtave të fëmijëve në shkollë;
- Në nivel komunal dhe institucional, organizohen takime informative dhe konsultative me prindër dhe me komunitetin me orar dhe agjendë të caktuara saktë;
- Takime të rregullta individuale me prindër;
- Takime të rregullta me komunitetin;
- Angazhimi aktiv i prindërve në realizimin e kurrikulave;
- Angazhimi i prindërve në aktivitete jashtëkurrikulare;
- Prindërit angazhohen për krijimin e një mjedisi të sigurt në shkollë;
- DKA përkrahë NNV dhe nxënësit me talente;

- Përkrahja e punës së Ekipit Komunal për Vlerësim;
- Infrastrukturë afirmative për të nxënë efektiv;
- Identifikimi i dhunës përmes pyetësorëve anonim;
- Ndërtimi i hapësirave të reja shkollore dhe renovimi e zgjerimi i hapësirave ekzistuese;
- DKA harton Rregulloren për mjedis miqësor për të nxënë efektiv;
- Organizimi i takimeve me organet e sigurisë;
- Furnizimi me material didaktik;
- Furnizimi me dru dekorativ i shkollave;
- Furnizimi me pajisje teknologjike i shkollave;
- Furnizimi me rekuizita sportive;
- Furnizimi i shkollave me naftë;
- Furnizimi i bibliotekave shkollore me libra;
- Furnizimi i shkollave me inventar;
- Furnizimi me makina pastrimi.

10. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.